


Kurti viziton ASK-në,
njoftohet me punën që po
bëhet për regjistrimin
e popullsisë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË REAGIMET PËR NDALIMIN E DINARIT SERB NË KOSOVË | FAQE 4-5

SHTOHET PRESIONI NDËRKOMBËTAR NDAJ KOSOVËS PËR DINARIN SERB



Edhe Komisioni Evropian u është bashkuar zërave kritikë ndaj Kosovës pas hyrjes në fuqi më 1 shkurt të një rregulloreje të Bankës Qendrore të Kosovës e cila parasheh përdorimin e euros për pagesat me para të gatshme,

duke ndaluar përdorimin e dinarit serb, që përdoret nga serbët që jetojnë në Kosovë. Zëdhënësi kryesor i KE-së, Eric Mamer, në një konferencë për medie mbajtur në Bruksel më 2 shkurt, tha se ky institucion

shpreh keqardhjen për këtë vendim dhe iu bashkohet thirrjeve të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë që të sigurohet një periudhë e mjaftueshme kohore për zgjidhjen e kësaj çështjeje nëpërmjet dialogut

AKTUALE



HARADINAJ VIZITON "VATRËN":
ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO,
SYNIMI YNË KRYESOR | F.2

PDK-JA PROPOZON KRIJIMIN E DY
KOMISIONEVE HETIMORE, NJËRIN
PËR RASTIN E GANI JAKUPIT,
TJETRIN PËR ZHUKJEN E
MOSTRAVE TË DEHARIT | F.6

KOMUNA E GJILANIT NDALON
EKSKURSIONET E NXËNËSVE
JASHTË SHETIT | F.7

EKONOMI



QEVERIA E KOSOVËS ZGJERON
SKEMËN "SUPERPUNA" | F.8

KRIPTORRËMUJË NË KOSOVË: LIGJI
ENDE I PAPËRFUNDUAR | F.8

SPORT



NË KRYEQYTET NDAJNË MEJDANIN
RIVALËT E VJETËR | F.10

DYSHIMET PËR
KEQPËRDORIME
NË NJËSITË PËR
PATENTË SHOFERË NË
KOSOVË, DURMISHI:
KEMI TË BËJMË
ME NDËRMARRJE
KRIMINALE | F.3



DEPUTETJA
MUSLIU TAKON
MIKE TURNER,
DISKUTOJNË
PËR SFIDAT
E FUNDIT TË
SIGURISË NË
KOSOVË | F.3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i ushtrisë paralajmëron që Rumania duhet të përgatitet për Putinin

BUKURESHT, 2 SHKURT - Rumania në mënyrë urgjente duhet ta miratojë bazën ligjore që do t'i lejojte vullnetarët civilë të ndjekin trajnime ushtarake, pasi që shteti ka nevojë të përgatitet më mirë në rast se lufta e Rusisë kundër Ukrainës zgjerohet. Kështu tha në një intervistë për Radion Evropa e Lirë shefi i ri i ushtrisë së Rumanisë, gjenerali Gheorghita Vlad. "Po, popullata e Rumanisë, sikurse e gjithë popullsia e Bashkimit Evropian, e Evropës, duhet të jenë të shqetësuar", tha gjenerali Vlad gjatë intervistës për Shërbimin Rumun të REL-it. "Personalisht, edhe pse jo nga aspekti i një ushtari të karrierës, mendoj se Federata Ruse nuk do të ndalet [në Ukrainë]. Nëse fiton në Ukrainë, synimi i saj kryesor do të jetë Moldavia. Ne do të shohim tensione edhe në Ballkanin Perëndimor. Jam më se i bindur se [presidenti rus, Vladimir] Putin do t'i përshkallëzojë politikat e tij në një të ardhme të afërt". Rusia nisi pushimin e paprovokuar të Ukrainës në

shkurt të vitit 2022, duke e sjell luftën në kufijtë veriorë të Rumanisë dhe në kufijtë në Detin e Zi. Rumania ka shfuqizuar shërbimin e detyrueshëm ushtarak më 2007, tri vjet pasi iu bashkua NATO-s dhe themeloi një ushtri profesioniste dhe trupa rezervë. Gjenerali Vlad tha se një projektligj i Ministrisë së Mbrojtjes aktualisht është në të dyja dhomat e Parlamentit rumun dhe debati për të pritet të zhvillohet pasi të përfundojnë zgjedhjet lokale, parlamentare dhe presidenciale që do të mbahen këtë vit. "Në mesin e gjërave të tjera ne duam të kemi një shërbim vullnetar ushtarak me afat të caktuar", tha Vlad, duke shtuar se programi do të ishte i ndarë nga ushtarët profesionistë, por pjesëmarrësit në këtë program do të paguheshin po ashtu. "Ne synojmë t'i tërheqim moshat mes 18 dhe 35 vjeç pavarësisht gjinisë, kombësisë apo fesë, të cilët duan ta veshin uniformën ushtarake. Ne duhet ta paguajmë



këtë lloj shërbimi dhe t'i trajnojmë pjesëmarrësit për rregullat bazike të luftës". Shefi i ushtrisë rumune, Gheorghita Vlad, tha se një program i tillë është i nevojshëm pasi rezervistët aktualë po plaken dhe nuk do të jenë në gjendje të përballeshin me sfidat e një konflikti ushtarak. "Imagjini një 50-

vjeçar duke mbajtur në shpinë një çantë ushtarake prej 80 litrash", tha ai. Rumania, një anëtare kyçe e kahut juglindor të NATO-s, ndan një kufi prej 650 kilometrash me Ukrainën. Aktualisht në ushtrinë e këtij shteti janë 80 000 ushtarë profesionistë. Gjenerali Vlad, që mori

udhëheqjen e ushtrisë rumune nëntorin e kaluar, tha se ky numër është i pamjaftueshëm duke pasur parasysh klimën aktuale gjeopolitike dhe duhet që numri i ushtarëve të rritet për 50 për qind. "Një numër adekuat për një ushtri profesionale rumune do të ishte rreth 120 000", tha ai.

GjND-ja vendos për juridiksionin në rastin e ngritur nga Ukraina kundër Rusisë

HAGË, 2 SHKURT - Gjykata më e lartë e Kombeve të Bashkuara më 2 shkurt do të vendosë nëse ka juridiksion në rastin e ngritur nga Ukraina kundër Rusisë pak pasi Moska nisi pushtimin në shkallë të plotë të fqinjit të saj pothuajse dy vjet më parë. Rasti i ngritur nga Kievi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) në Hagë, akuzon Rusinë se ka shkelur Konventën e Gjenocidit të vitit 1948, duke pretenduar rrethshëm se pushtimi i 24 shkurtit të vitit 2022 u nis në mënyrë që të frenojë një gjenocid të supozuar ndaj rusishtfolësve në lindje të Ukrainës. Në vendimin paraprak, gjykatësit e GjND-së urdhëruan Rusinë në mars të vitit 2022 që ta ndalte pushtimin, por Moska e



refuzoi vendimin, duke argumentuar se gjykata, që zgjidh mosmarrëveshjet ligjore të ngritura nga shtetet lidhur me pretendimet për shkelje të së

drejtës ndërkombëtare, nuk kishte të drejtë ligjore për të vendosur për këtë rast. Në shtatorin e vitit të kaluar avokatët e Rusisë i kërkuan

gjykatës që ta hidhte poshtë rastin, duke përsëritur qëndrimin se GjND-ja nuk ka juridiksion. Gjatë asaj seance dëgjimore Ukraina tha se injorimi i vendimit të gjykatës nga Rusia përbën sulm ndaj autoritetit të GjND-së. "Çdo raketë që Rusia gjuan ndaj qyteteve tona e lëshon në kundërshtim me këtë gjykatë", tha Anton Korynevich, përfaqësues i Ukrainës në këtë gjykatë. Përderisa vendimet e GjND-së janë ligjrisht të obligueshme, gjykata nuk ka mjete që ato të zbatohen. Në një rast të ndarë më herët gjatë kësaj jave, GjND-ja publikoi një vendim për një rast të ngritur nga Ukraina kundër Rusisë për financim të terrorizmit, rast që

kishte të bënte me aktivitetet e Moskës dhe për "diskriminim racor" nga Rusia pasi Kremlini aneksoi paligjshëm Gadishullin e Krimesë më 2014. Në vendimin e publikuar më 31 janar, gjykata tha se përderisa Moska ka shkelur traktatet kundër diskriminimit të OKB-së, duke dështuar që ta mbrojtë arsimin në gjuhën ukrainase në Krime, GjND-ja nuk u pajtua me pretendimin e Ukrainës se Rusia duhet ta kompensojë atë. Gjykata, po ashtu, hodhi poshtë pretendimet e Ukrainës se Rusia ka diskriminuar tatarët etnikë dhe ukrainasit pas aneksimit të Krimesë. Në përgjithësi, GjND-ja u pajtua me Ukrainën se Moska kishte shkelur dy nene të traktateve, por refuzoi të tjerat.

Hamas jep miratim "fillestar" për planin e armëpushimit në Gazë

GAZA, 2 SHKURT - Luftimet në Gazë vazhduan edhe më 2 shkurt, teksa u raportua për dhjetëra të vrarë gjatë natës. Këto njoftime erdhën në kohën kur Katarit tha se Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - ka dhënë miratim "fillestar" për një marrëveshje

për lirim të pengjeve në këmbim të të burgosurve. Një marrëveshje e tillë do ta paузonte luftën mes radikalëve palestinezë dhe Izraelit. Ministria e Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamas tha se 105 persona janë vrarë brenda 24 orëve të fundit përderisa janë raportuar bombardime dhe luftime në

Han Junis, qytetin në jug të Gazës. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Katarit, Majedal-Ansari, tha se gjatë bisedimeve të fundit në Paris, mes zyrtarëve të Katarit, Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Egjiptit, është diskutuar për një propozim për armëpushim në Gazë.




Kurti viziton ASK-në, njoftohet me punën që po bëhet për regjistrimin e popullsisë

Prishtinë, 2 shkurt - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë vizituar Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Ata kanë bashkëbiseduar me ushtruesin e detyrës, Avni Kastrati dhe ekipin e drejtorëve të këtij institucioni. Pas vizitës së fundit në ASK në muajin dhjetor, kryeministri pati mundësinë të njoftohej për me punën e cila po

zhvillohet në kuadër të regjistrimit të popullsisë që do të nisë në muajin prill. "Rreth dy muaj na ndajnë nga nisja e regjistrimit të popullsisë. Statistikat e sakta janë të rëndësishme e të nevojshme për shtetin, për zhvillimin e vendit dhe targetimin e duhur të politikave e strategjive të qeverisë. Përkushtim i lartë, energji dhe vullnet nevojiten për ta planifikuar e zhvilluar me sukses regjistrimin e

popullsisë, në mënyrë gjithëpërfshirëse e të qasshme për të gjithë qytetarët tanë, nga të gjitha komunitetet e në secilin lokalitet", ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti ritheksoi mbështetjen e plotë të qeverisë ndaj ASK-së për realizimin e procesit me standardet e kushtet teknike të nevojshme, duke ofruar dhe gatishmëri të plotë të ndihmë sa iu përket sfidave dhe nevojave të ndryshme.



Deputetja Musliu takon Mike Turner, diskutojnë për sfidat e fundit të sigurisë në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në Kuvendin e Kosovës, Ganimete Musliu, gjatë qëndrimit në ShBA, ka zhvilluar takim me kryesuesin e Komisionit për Inteligjencë në Dhomën e Përfaqësuesve në Kongresin e ShBA-së, Mike Turner (R, Ohio-10).

Gjatë takimit të tyre është folur për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave, me zotim se do të vazhdohet bashkëpunimi i deritashëm me interes të dyanshëm.

Deputetja Musliu e informoi kongresistin Turner lidhur me sfidat e sigurisë me të cilat po ballafaqohet Kosova së fundmi, por edhe për angazhimin e komisionit që udhëheq për një bashkëpunim sa më të mirë dhe mbikëqyrje sa më profesionale të Agjencisë së Kosovës për

Inteligjencë.

Po ashtu, Musliu potencoi bashkëpunimin e shkëlqyer që AKI ka me institucionet relevante në ShBA dhe përkrahjen e deritashme që i është ofruar qoftë AKI-së drejtpërdrejt, qoftë institucioneve të tjera të sigurisë në Kosovë.

Nga aspekti i legjislacionit, kongresisti Turner u njoftua për procesin e plotësim-ndryshimit të ligjit për veprimtarinë e AKI-së, me të cilin parashihet përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të këtij institucioni.

Lidhur me plotësim-ndryshimin e ligjit për veprimtarinë e AKI-së, Musliu tha se mirëpret sugjerimet nga praktikantët më të mira të komisionit homolog nga kongresi.

Kongresisti Turner u njoftua nga Musliu edhe me rrethanat aktuale teknike dhe operacionale në të cilat vepron Komisioni për Mbikëqyrjen e



Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si dhe me mungesën e hapësirës adekuate për ta ushtruar funksionin, në të cilin do të shkëmbeheshin informatat sensitive dhe me interes për komisionin.

Kongresisti Turner ka qenë për vizitë në Kosovë në gusht të vitit 2023 (anëtar i komisionit aktual

është nga viti 2015, kurse kryesues nga janari i vitit 2023) dhe është i njohur me zhvillimet, ndërsa ishte i hapur për bashkëpunim duke ofruar çdo lloj asistence (shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim teknik) në mënyrë që Komisioni për Mbikëqyrje të AKI-së të përfitojë nga praktikantët më të

mira amerikane.

Nga aspekti operacional, kongresisti Turner ndau edhe informatën se komisionet e ndryshme parlamentare (NATO, BE, Mbretëri të Bashkuar etj.) kanë praktika të ndryshme dhe se duhet parë se mos janë më të përshtatshme për rrethanat aktuale në Kosovë.

Kaos me mbeturina në kryeqytet, Rama liron nga detyra drejtorin e Shërbimeve Publike



PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka liruar nga detyra drejtorin e Shërbimeve Publike, Ilirik Musliu. Rama në "Facebook" ka shkruar se që një vit ka kërkuar zgjidhje për situatën alarmante me mbeturina në kryeqytet. "Sot kam marrë vendim për ta liruar nga detyra drejtorin e Shërbimeve Publike. Për më tepër, ju njoftoj se, në cilësinë e kryetarit të kryeqytetit, kam

bërë përpjekje duke krijuar një Task Force dhe kam ndarë buxhet shtesë për këtë drejtori dhe ndërmarrjen përkatëse, por përkundër kësaj mbështetje të vazhdueshme nuk ka pasur rezultate nga drejtorja në fjalë. Prandaj, kam vendosur që të ndërhyjë dhe të marrë përsipër zgjidhjen e kësaj situatë", ka njoftuar Rama. Ai ka theksuar se të gjithë jemi dëshmitarë të gjendjes aktuale

alarmante në kryeqytet lidhur me menaxhimin e mbeturinave. "Si kryetar i kryeqytetit, tash e një vit kam kërkuar në vazhdimësi nga drejtorja përkatëse zgjidhje të kësaj situatë alarmante dhe të papranueshme. Por, përkundër të gjitha këtyre kërkesave, gjendja jo që nuk është përmirësuar, por përkundrazi është përkeqësuar", ka shkruar Rama.

Komuna e Gjilanit ndalon ekskursionet e nxënësve jashtë shtetit

GJILAN, 2 SHKURT - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka marrë vendim për ndalimin e ekskursioneve të nxënësve jashtë shtetit. Këtë vendim kreu i Gjilanit tha se e ka marrë në bashkërendim të

plotë me këshillin e prindërve të komunës. "Substancat narkotike, pijet alkoolike, lëndimet e rastet e ndryshme si dukuri negative, si dhe shpenzimet e mëdha familjare, ishin disa nga arsyet e

konkluzionet e përbashkëta mes nesh dhe këshillit të prindërve. Do t'i shohim alternativat e aktiviteteve të tjera edukative e kulturore, në të mirë për të gjithë maturantët tanë!", ka thënë kryetari Hyseni.





VAZHDOJNË REAGIMET PËR NDALIMIN E DINARIT SERB NË KOSOVË

Shtohet presioni ndërkombëtar ndaj Kosovës për dinarin serb

Edhe Komisioni Evropian u është bashkuar zërave kritikë ndaj Kosovës pas hyrjes në fuqi më 1 shkurt të një rregulloreje të Bankës Qendrore të Kosovës e cila parasheh përdorimin e euros për pagesat me para të gatshme, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb, që përdoret nga serbët që jetojnë në Kosovë. Zëdhënësi kryesor i KE-së, Eric Mamer, në një konferencë për medie mbajtur në Bruksel më 2 shkurt, tha se ky institucion shpreh keqardhjen për këtë vendim dhe iu bashkohet thirrjeve të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë që të sigurohet një periudhë e mjaftueshme kohore për zgjidhjen e kësaj çështjeje nëpërmjet dialogut

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 2 shkurt - Komisioni Evropian u është bashkuar zërave kritikë ndaj Kosovës pas hyrjes në fuqi më 1 shkurt të një rregulloreje të Bankës Qendrore të Kosovës. Kjo rregullore parasheh përdorimin e euros për pagesat me para të gatshme, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb, që përdoret nga serbët që jetojnë në Kosovë.

Zëdhënësi kryesor i KE-së, Eric Mamer, në një konferencë për media në Bruksel më 2 shkurt, ka thënë se ky institucion shpreh keqardhjen për këtë vendim dhe iu bashkohet thirrjeve të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë që të sigurohet një periudhë e mjaftueshme kohore për zgjidhjen e kësaj çështjeje përmes dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Komisioni

shpreh keqardhjen për faktin se ky vendim është miratuar pa konsultime paraprake, duke marrë parasysh pasojat që ky vendim mund të ketë në jetën e përditshme të serbëve në Kosovë dhe komuniteteve të tjera në Kosovë. Komisioni është veçmas i shqetësuar për ndikimin të shkollat dhe spitalet, duke marrë parasysh se nuk ka alternativa të tjera", ka thënë Mamer.

Mamer ka thënë se KE-ja mbështet deklaratën e lëshuar një ditë më parë edhe nga përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha të mërkurën se zbatimi i rregullores për pagesat me para të gatshme do të bëhet përmes një tranzicioni të lehtësuar, pa treguar sa do të zgjasë kjo. "Komisioni merr në dijeni vendimin e BQK-së për të lejuar një fazë tranzicioni. KE-ja i kërkon Kosovës të sigurojë që ky

afat tranzitor të jetë mjaftueshëm i gjatë për të gjetur një zgjidhje të negociuar në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja", ka thënë Mamer.

Në pyetjet pse KE-ja dhe BE-ja po kritikojnë një shtet që përdor euron dhe vendimin e një institucioni të pavarur, siç është BQK-ja, zëdhënësi Mamer tha se në këtë rast po kritikohet mënyra se si është miratuar vendimi. "Nuk duhet të keqinterpretohet deklarata jonë. Nuk e kemi kritikuar Kosovën për vendosjen e euros apo vendimin se cila valutë duhet të përdoret. Kemi komentuar vetëm faktin se ky vendim u miratua pa konsultime paraprake. Sepse në këtë moment keni njerëz, institucione, përfshirë edhe spitale të cilat veprojnë në një kornizë, duke marrë ndihmë financiare nga Serbia, dhe ato duhet të kenë kohë të mjaftueshme që të përgatiten", ka thënë ai.

Ai ka thënë se kjo çështje është

dashur të adresohet në dialogun për normalizim, "para se të shpallej vendimi në mënyrë që të gjendej një zgjidhje praktike, që njerëzit dhe institucionet të përshtateshin".

Edhe zëdhënësi i BE-së për çështje të sigurisë, Peter Stano, ka thënë se blloku nuk po e kritikon vendimin, por mënyrën se si u mor ai. "Nuk ka të bëjë absolutisht asgjë me euron, por me mënyrën se si ky vendim është miratuar dhe rrezikun që ai sjell", ka thënë Stano.

Zbatimi i rregullores së BQK-së për operacione me para të gatshme është kritikuar edhe nga Shtetet e Bashkuara. "Dua ta përsëris çka kanë thënë Shtetet e Bashkuara. Ne kemi shqetësime të thella dhe rezerva për zbatimin e saj para se ajo të jetë plotësisht e përgatitur. Mund ta them me siguri se ne e kundërshtojmë atë tani", ka deklaruar më 1 shkurt ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier.

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka thënë të enjten se vendimi "i njëanshëm" i Kosovës për ta zbatuar një rregullore të Bankës Qendrore të Kosovës - e cila përcakton që vetëm valuta euro të përdoret për pagesa me para të gatshme në gjithë vendin - ia kufizon mundësitë ShBA-së për të avokuar për Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Me gjithë trysnin ndërkombëtare, Kosova e nisi më 1 shkurt zbatimin e rregullores, e cila i jep

fund përdorimit të dinarit serb në vend, megjithëse përmes një periudhe të papërcaktuar tranzicioni të lehtësuar. "Qeverisja e mirë dhe partneriteti i mirë ndërkombëtar kërkohen kohë për t'i vlerësuar pasojat, për t'i dëgjuar perspektivat dhe për t'u konsultuar me të tjerët për gjetjen e një zgjidhjeje funksionale", ka thënë DASH-i për "Radion Evropa e Lirë".

DASH-i i bëri thirrje Kosovës ta shtyjë zbatimin e këtij vendimi "menjëherë", derisa, siç tha, të vendosen procedura të kënaqshme në përputhje me standardet evropiane dhe popullata të jetë edukuar mjaftueshëm se si do të vazhdojë periudha e tranzicionit. "Vendimi u shpall pa përgatitje apo konsultim adekuat. Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të zhgënjyera dhe i kundërshtojnë planet e tanishme të Kosovës për ta vazhduar zbatimin e vendimit për kufizimin e importit të valutave të huaja, përfshirë të dinarit serb", ka theksuar DASH-i. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se vendimi i autoriteteve të Kosovës për anulimin e dinarit serb është sulm ndaj të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara nga viti 1999, dhe se Serbia do të gjejë institucione që do të marrin licenca për ta mundësuar dërgimin e parave për serbët në Kosovë. "Në secilin prej atyre akteve është e drejtë e Serbisë të finançojë aktivitetet

Dyshime për keqpërdorime në njësitë për patentë shoferë në Kosovë, Durmishi: Kemi të bëjmë me ndërmarrje kriminale

PRISHTINË, 2 SHKURT - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, në një konferencë për medie mbajtur të premtën, ka treguar për të gjeturat dhe keqpërdorimet në njësitë për patentë shoferë në Kosovë. Durmishi gjatë konferencës ka thënë se gjatë këtyre tri viteve kanë bërë përpjeke maksimale që situata për patentë shofer të stabilizohet. Ai tha se, përkundër punës së tyre të vazhdueshme, fatkeqësisht, keqbërësit gjejnë forma e metoda të ndryshme që ta korruptojnë sistemin dhe pajisja me patentë shoferë të bëhet në kundërshtim me ligjin. “Detyra jonë është t’i luftojmë fuqishëm këto dukuri dhe për çdo dyshim më të voglin të marrim masa dhe t’i njoftojnë organet e drejtësisë. Pajisja me patentë shofer me metoda korruptive është krim, pasi ata shoferë që sot po flasim ndodhen në komunikacion, rrezikojnë veten dhe jetën e të tjerëve. Shumica e aksidenteve po bëhen për shkak të mosrespektimit të rregullave në trafik, prandaj lufta jonë ndaj atyre që janë të përfshirë do të jetë e pakompromis”, ka thënë Durmishi. Durmishi duke folur për të gjeturat në njësitë për patentë-shoferë, tha se dyshimet janë se rastet kanë të bëjnë me ndërmarrje kriminale. “Nga ajo që kemi gjetur deri më tani,



bëhet fjalë për një ndërmarrje të gjerë kriminale e cila mbetet të vërtetohet nga organet e drejtësisë. Dyshimet tona kanë filluar nga informatat e shumta që na dërgonin qytetarët. Pas analizimit të statistikave vjetore që jemi njoftuar nga departamenti, na kanë njoftuar se ka dyshime për keqpërdorime të shumta...”, u shpreh ai. Ai tha se ka qindra raste të dyshuara për keqpërdorime dhe

qyteti që prin është Peja. “Gjatë monitorimit jemi informuar që të njëjtët kanë vizituar disa njësi të ndryshme si në Prizren, Prishtinë, Gjilan dhe Pejë. Gjatë monitorimit të këtyre qendrave kemi hasur në keqpërdorime të ndryshme, por në njësinë e patentë-shoferëve në Pejë kemi hasur në një dukuri që në njësitë e tjera nuk ka ndodhur. Në këtë njësi kishte 666 kandidatë gjatë vitit 2023 që kishin kaluar

provimin praktik në kategorinë B, C dhe C1 e të gjithë këta kandidatë kanë qenë nga qytete të ndryshme të Kosovës. Prijnë Podujeva, Malisheva, Gjilani, Drenasi, Kamenica, Fushë-Kosova etj”, theksoi Durmishi. Ka raste kur ka rënë 10 herë në Prishtinë dhe ka shkuar pastaj në Pejë. Është shumë e dyshimtë që një kandidat shkon në Pejë për të kaluar provimin në pjesën praktike”, theksoi Durmishi.

Ditë më parë Ministria e Infrastrukturës ua ka ndërprerë marrëdhënien e punës tre ekzaminerëve të angazhuar në Departamentin për Patentë Shofer. Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, kishte thënë se vendimi është marrë pas informatave për dyshime të bazuara në keqpërdorime të mëdha në procesin e punës.

caktuara, shëndetësi, arsim, pensione”, ka thënë Vuçiqi të premtën në një konferencë për media. Fatkeqësisht, Albin Kurti e ka marrë atë vendim me iniciativën e tij, me qëllimin e mëposhtëm: spastrim etnik të popullit serb nga territori i Kosovës dhe Metohisë”, ka thënë Vuçiqi, duke iu referuar kryeministrit të Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal në Kosovë lejon dërgimin e ndihmave financiare nga Serbia. Shteti serb i ka ndarë 139 milionë euro për serbët në Kosovë për vitin 2024, rreth 11 milionë më shumë sesa më 2023. Në konferencën për medie, Vuçiqi ka thënë se do të bëjë gjithçka që serbët në Kosovë t’i marrin sërish të ardhurat e tyre. Presidenti serb ka thënë se deri në mesditën e së premtes për serbët në Kosovë janë ndarë më shumë se 5 milionë euro për përfitime të ndryshme. Ai bëri me dije se Serbia do të kërkojë zgjidhje se si t’i dërgojë paratë për serbët në Kosovë. Kur ka folur për fondet që ndan Serbia, Vuçiqi ka treguar se shteti i tij i ka 31 831 të punësuar në Kosovë, 29 115 pensionistë - prej të cilëve 4 700 i marrin pensionet në dorë - si dhe 31 586 shfrytëzues

të ndihmës sociale. Vuçiqi ka paralajmëruar se të hënën e javës së ardhshme Serbia do të vazhdojë të dërgojë dinarë në Kosovë përmes një “transportuesi të licencuar dhe të autorizuar, përmes kompanisë britanike ‘Henderson’, në përputhje me ligjet”. Banka Popullore e Serbisë i ka dërguar prej vitesh dinarët në një kasafortë në komunën e Leposaviqit, në veri të Kosovës, ato më pas janë transportuar nga kompania ndërkombëtare “Henderson”. Që nga paslufta më 1999, Serbia, e cila nuk e njih pavarësinë e Kosovës, ka përdorur dinarin për t’i paguar pensionet, ndihmat sociale dhe pagat për institucionet paralele që ka në Kosovë, përfshirë këtu edhe spitalet dhe shkollat. Banorët e dhjetë komunave me shumicë serbe në Kosovë e kanë shfrytëzuar dinarin edhe për pagesat në dyqane dhe restorante. Qeveria e Kosovës ka deklaruar se rregullorja e BQK-së nuk nënkupton se do të ndalen transferet e parave nga Serbia dhe, po ashtu, nuk nënkupton dënime financiare për posedimin e valutave të shteteve të tjera.

Konjufca, Hovenierit për shqetësimin që ngriti për dinarin: Sigurojmë se nuk do të ketë turbulenca

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka siguruar se nuk do të ketë tensione vetëm pse dinari është hequr nga përdorimi si valutë. Ai u është përgjigjur shqetësimeve të ambasadorit amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ku ka theksuar se nuk do të ketë trazira lidhur me këtë vendim të BQK-së. “Shqetësimi ishte që mund të ketë turbulenca për shkak të këtij vendimi. Ne i sigurojmë se kjo nuk do të ndodhë dhe që siguria do t’u ofrohet të gjithëve. Situata nuk del prej kontrollit pse dinari është hequr nga përdorimi si valutë”, ka theksuar ai. Konjufca ka thënë se shfrytëzimi i dinarit serb në territorin e

Kosovës është dashur të ndërpritet menjëherë pas luftës. Kështu ka thënë ai në një prononcim para gazetarëve, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, për caktimin e rendit të ditës për seancën e radhës plenare. “Dinari dhe shfrytëzimi i tij është dashur të ndërpritet kur Serbia është larguar nga Kosova, pas luftës çlirimtare dhe bombardimeve të NATO-s. Por, prej vitit 2001, askush nuk ka dyshim që dinari ka qenë gjithmonë ilegal, tjetër gjë që është përdorur në mënyra të ndryshme prej institucioneve paralele që i ka pasur Serbia këtu. Nuk bëhet fjalë vetëm për mjekët dhe mësuesit, por janë financuar edhe shumë persona

të rrezikshëm”, ka thënë Konjufca. Sipas tij, kjo që ka ndodhur tash me rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës është vetëm një zbatim i një principit. “Nëse ju thoni se është dashur t’i mbledhim ndërkombëtarët dhe t’i njoftojmë, kjo është një temë tjetër. Ka mundur të ndodhë, por kjo është konsideruar një çështje që nuk do të shkaktojë probleme dhe turbulenca për shkak se ligji është i shkruar dhe dihen rregullat”, ka thënë kryetari i Kuvendit. Ai ka theksuar se BQK-ja është institucion i pavarur dhe se Qeveria e Kosovës nuk mund t’i fusë duart në çështjet që i përkasin këtij institucioni.

Zgjatet linja 15 e autobusit deri në fshatin Hajkobillë

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se është zgjatur linja 15 e autobusit deri në fshatin Hajkobillë.

Rama thotë se zgjerimi i kësaj linje u mundëson banorëve qasje më të lehtë në transport publik. “Zgjatet linja 15 e autobusit deri në

fshatin Hajkobillë! Me vendimin që kam marr, kjo linjë e autobusëve e Trafikut Urban ju mundëson të gjithë banorëve të zonës qasje më të lehtë në transport publik, rrjedhimisht qasje më të lehtë në shërbime, punë, arsim dhe aktivitete të tjera esenciale”, ka deklaruar

Rama. Kohën e fundit shumë qytetarë janë ankuar se autobusët e Trafikut Urban po vonohen dhe se nuk janë të rregullt. Ndërkaq, nga Trafiku Urban kanë deklaruar se fajtor për këtë është komunikacioni i dendur.



Në muajin janar policia rajonale e Ferizajt ka shqiptuar mbi 6 000 gjoba



FERIZAJ, 2 SHKURT - Gjatë muajit janar policia rajonale e Ferizajt ka shqiptuar 6 100 gjoba për kundërvajtje, ndërsa ka hequr edhe 141 patentëshoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion, ku parashihet masa mbrojtëse - heqje e patentë shoferit. “Disa nga kundërvajtjet e shkaktuara në komunikacionin rrugor janë tejkalim i shpejtësisë, 1553 gjoba; Mospërdorimi i rripit të sigurisë, 626 gjoba; Përdorimi i telefonit gjatë ngasjes, 464 gjoba; Xhamat e errët, vendosja e foljes ose materialit tjetër, 261 gjoba; Drejtimi i mjetit pa patentë shofer, 192

gjoba; Skadimi i afatit të regjistrimit të automjetit, 150 gjoba; Tejkallim në vijë të plotë, apo vend të ndaluar, 53 gjoba; Kërcënime dhe pa rregullt në rrugën kryesore, 34 gjoba; Drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit, 18 gjoba; Mjetet pjesëmarrëse në trafik pa sinjalizim të duhur ndriçues, 5 gjoba; Tejkallim i kolonës së automjeteve, 4 gjoba; Mosrespektimi i këmbësorëve, 3 gjoba; Të tjera, 2737 gjoba”, ka njoftuar policia.

Policia rajonale e Ferizajt ka theksuar se do t'i vazhdojë aktivitetet, me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor.

Komuna e Kamenicës, me ndryshime të mëdha në çerdhen e fëmijëve

KAMENICË, 2 SHKURT - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka njoftuar se tashmë fëmijët në çerdhen e Kamenicës do të konsumojnë vetëm ushqim të shëndetshëm. “Gjatë vizitave të mia atje kam parë që fëmijët deri vonë nuk janë ushqyer shëndetshëm për shkak se e njëjta meny ka qenë për të gjithë fëmijët e të gjitha grupmoshave në çerdhe dhe, gjithashtu, menya ka qenë e pasur me ushqime tejet të procesuara, jo të shëndetshme dhe rrallëherë me prejardhje vendore. Këtë e kemi ndryshuar dhe jam shumë e lumtur për këtë”, ka thënë nutricionistja Diellza Arifi.

Drejtoresha e IP “Filizat”, Xhevrije Krasniqi, ka thënë se të ushqyerit e shëndetshëm është mjaft i rëndësishëm në çdo fazë jetësore e aq më



shumë në fëmijërinë e hershme. “Në institucionin parashkollor ‘Filizat’ fëmijët ushqehen me ushqime të shëndetshme, gjë që ndikon

në rritjen dhe zhvillimin e tyre, ku konsideroj se është një përparësi mjaft e madhe për këtë institucion”, ka thënë Krasniqi.



Nis hartimi i projekteve të restaurimit për pesë monumente të trashëgimisë islame të Kosovës

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministria e Kulturës ka njoftuar se ka nisur hartimi i projekteve të restaurimit për pesë monumente të trashëgimisë islame të Kosovës. Projektet e restaurimit për Xhaminë e Madhe në Ferizaj,

Xhaminë e Çokut në Junik, Xhaminë e Sudi Efendisë në Prishtinë, Xhaminë e Orllanit në Podujevë dhe Xhaminë e Burojës në Skenderaj, u paraprijnë ndërhyrjeve restauruese të cilat do të nisin sapo të përfundojnë projektet.

Aksion në rajonin e Pejës kundër veprimtarive të strukturave ilegale

PEJË, 2 SHKURT - Policia e Kosovës dhe Prokuroria kanë zhvilluar një aksion të premtën në rajonin e Pejës

kundër veprimtarive të strukturave ilegale. Lajmin për medie e ka dhënë zëdhënësi i Prokurorisë së

Pejës, Shkodran Nikçi. Aksioni është zhvilluar në Gorazhdec, Pejë, Klinë dhe Istog kundër veprimtarive të

strukturave ilegale. “Prokuroria dhe policia po zhvillojnë një aksion”, ka njoftuar Nikçi.



Vitia: Së shpejti do ta nisim ligjin e ri për sigurime shëndetësore

Prishtinë, 2 shkurt - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka raportuar të premten në Komisionin për Shëndetësi. Para anëtarëve të komisionit, Vitia përmendi disa të arritura që kanë shënuar gjatë vitit 2023. Ai ka thënë se kanë zvogëluar pritjet në disa klinika. Ai ka përmendur edhe Klinikën e Radiologjisë. “Në Ortopedi kemi bërë renovim të sallave, do të blihen edhe

aparatura të reja e proteza të ndryshme. Po punohet edhe në spitalet e tjera. Në Klinikën e Kardiologjisë ka pasur rekord të ndërhyrjeve. Kjo po zgjerohet edhe në Prizren. Po ashtu, në Kirurgjinë Vaskulare po investojmë në salla. Çdo investim në salla rrit volumin e punës”, ka deklaruar ai. Ministri Vitia tha se kanë bërë investime edhe në

Klinikën e Neurokirurgjisë. Gjithashtu, ai tha që së shpejti do të nisim edhe ligjin e ri për sigurime shëndetësore. “Ligji për ndalimin e duhanit, ligji për inspektorat, ligji për barna, janë në finalizim”, potencoi ai. Ministri Vitia ka theksuar se gjatë vitit 2024 synojnë që sa më shumë të përmirësohet cilësia e shërbimeve në spitale.



Një person dënohet me 13 vjet burgim për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur fajtor Dushko Arsiqin për krime lufte ndaj popullatës civile, konfirmoi avokati i tij mbrojtës, Nebojsa Vllaiq. Arsiq ishte arrestuar më 8 dhjetor 2023 nën dyshime për krime të kryera në periudhën janar-qershor 1999 në rajonin e Prishtinës. Në aktakuzë thuhet se kishte marrë pjesë në vrasjen e B. Sh. më 20 prill të vitit 1999 në Butovc të Prishtinës dhe kishte maltretuar fizikisht dhe psikikisht A. K., atëbotë 15 vjeç. Arsiq, së bashku me pjesëtarë të tjerë të policisë serbe dhe grupeve paramilitare, në periudhën janar-qershor të vitit 1999 kishte marrë pjesë në dëbimin dhe shpërnguljen e qytetarëve nga Prishtina dhe rrethina, u tha në aktakuzë. Aty,

po ashtu, u tha se Arsiq, së bashku me një grup tjetër, kishin plaçkitur dhe më pas dëmtuar pronat e shqiptarëve, duke ua vënë zjarri. Arsiq është akuzuar për keqtrajtim të civilëve shqiptarë, plagosje dhe vrasje. Avokati i tij, Nebojsa Vllaiq, pas shqiptimit të dënimit nga gjykata e shkallës së parë, tha se klienti i tij është akuzuar dhe dënuar për krime lufte vetëm se u përpoq ta rimarrë pasurinë që i ishte uzurpuar dhe të kthehej në Prishtinë. Vllaiq tha se do të apelojë këtë vendim. Arsiq ishte arrestuar në veri të Kosovës në dhjetorin e kaluar dhe atëbotë, Zyra e Prokurorisë Speciale, nuk kishte dhënë më shumë hollësi, duke u thirrur “në ndjeshmërinë e rastit”. Ariq është me origjinë nga



Matiqani, që gjendet në periferi të Prishtinës, dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë kishte jetuar në Kralëvë të Serbisë, ka thënë më herët për Radion Evropë e Lirë ekipi i tij mbrojtës. Gjatë seancave

gjyqësore ai është deklaruar i pafajshëm. Dhjetorin e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës kishte thënë se ka ngritur gjithsej 33 akuza, që përfshijnë 89 persona për krime lufte në Kosovë.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

PDK-ja propozon krijimin e dy komisioneve hetimore, njërin për rastin e Gani Jakupit, tjetrin për zhdukjen e mostrave të Deharit



PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që seanca e radhës të jetë të enjten, më 8 shkurt. Kështu ka bërë me dije shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ndërsa ka theksuar se si grup parlamentar kanë propozuar themelimin e dy komisioneve hetimore. “Në njërin komision hetimor kemi propozuar të bëjmë hetim parlamentar në kuadër të

Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kemi pasur prova të mjaftueshme për degradimin e shërbimit diplomatik dhe kontratës për njerëz të angazhuar me shuma marramendëse që nuk kanë ndodhur më herët në Republikën e Kosovës, siç është rasti i Gani Jakupit, i cili paguhet me një pagë që kalon çdo standard të pagave që paguhen nga buxheti i Kosovës. Kemi

informacione që ka edhe raste të tjera të angazhimit të njerëzve si rasti i Gani Jakupit, por që nuk po bëhen publike”, ka thënë Tahiri. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, po ashtu, tha se kanë propozuar edhe krijimin e një komisioni hetimor për rastin e zhdukjes së mostrave të Astrit Deharit. Ai tha se si grup parlamentar kanë denoncuar dy herë edhe zjarrvënien në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Haradinaj viziton “Vatrën”: Anëtarësimi i Kosovës në NATO, synimi ynë kryesor

Prishtinë, 2 shkurt - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, gjatë qëndrimit të tij në ShBA, ka vizituar Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës “Vatra”, në të cilën kanë diskutuar për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon si dhe për rolin e rëndësishëm të diasporës, veçanërisht lobin shqiptaro-amerikan. Haradinaj ka thënë se

Amerika nuk është vetëm aleatja kryesore strategjike, por edhe shtëpia për mijëra shqiptarë që u larguan nga vendi në kërkim të një jete më të mirë. “Vlerësova rolin e ‘Vatrës’ në ndihmë të shtetit të Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi në të gjitha etapat. Në takim të përzemërt e vëllazëror fola hapur për nevojën e vazhdueshme që të gjitha

organizimet shqiptare në Amerikë të vazhdojnë ta ndihmojnë Kosovën në të gjitha sferat. Theksova se anëtarësimi i Kosovës në NATO është synimi ynë kryesor, sepse i bënë Kosovën dhe rajonin më të sigurt dhe e ndihmon paqen në botë, gjithnjë krah ushtrive të vendeve demokratike në krye me Amerikën”, ka thënë Haradinaj pas kësaj vizite.



Kriptorrëmujë në Kosovë, ligji ende i papërfunduar

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ka dy vjet e gjysmë që Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë nismën për hartimin e një ligji që do ta rregullonte fushën e monedhave virtuale - të njohura si kriptovaluta, por ende pa sukses.

Zyrtarë të partisë në pushtet pranojnë se ka pasur vonesa, por thonë se drafti i ligjit është drejt përfundimit.

Ata të opozitës pretendojnë se ligji, thjesht, është neglizhuar.

Nga viti 2022, kur Kosova është përballur me krizë energjetike, qeveria e ka ndaluar mihjen e kriptovalutave, meqë procesi shpenzon shumë rrymë.

Autoritetet e rendit raportojnë vazhdimisht për konfiskim të pajisjeve që përdoren për prodhimin e tyre.

Analistët e tregut e përshkruajnë si "kaotik" tregun e kriptovalutave në vend.

Çfarë janë kriptovalutat?

Kriptovalutat janë para digjitale. Personit i duhet një "portofol", apo një aplikacion online, përmes të cilit transferon para reale për blerjen e kriptovalutave. Ato mund të përdoren, pastaj, për të blerë mallra dhe shërbime të zakonshme, ndonëse shumë njerëz investojnë në to sikurse në pasuri të tjera, të tilla si aksionet apo metalet e çmueshme.

Në botë ekzistojnë mbi .000 kriptovaluta të ndryshme, por më të popullarizuarat mbeten Bitcoin dhe Ethereum.


Evidencë të saktë të personave që operojnë me kriptovaluta në Kosovë nuk ka.

Këtë gjë pritet ta rregullojë ligji. Por, besohet se ato kanë arritur në vend së paku nga viti 2017.

Çfarë do të përfshijë ligji?

Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë nismën për hartimin e një ligji të kriptovalutave në verë të vitit 2021.

Në krye të grupit punues për këtë ligj është vënë Mimoza Kusari Lila nga Lëvizja Vetëvendosje në pushtet. Atëkohë ajo ka thënë se me ligj nuk synohet të ndalohet veprimtaria me monedhat



digjitale, por se të futet nën kontroll, duke i verifikuar pajisjet e importuara për prodhimin e tyre, veprimtarinë e transakcioneve dhe formën e tatimit. Kjo ide, sipas saj, ka lindur pas shqetësimeve për rritje të konsumimit të rrymës në mënyrë të paligjshme në veri të Kosovës, si dhe me qëllim që të parandalohet krimi i organizuar dhe veprimtaritë jolegale me kriptovaluta.

Pse nuk ka ende ligj?

Jeta Statovci e Lëvizjes Vetëvendosje - njëherësh nënkryetare e Komisionit parlamentar për Industri, Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti, i cili është marrë me këtë nismë - thotë se drafti i ligjit është pothuajse gati. "Rreth 90 për qind i përfunduar", sipas saj. Statovci thotë se vonesat deri më tash kanë ndodhur për shkak se Komisioni Evropian "ka dërguar dy këshilltarë për të trajtuar brenda këtij projektligji edhe dimensionin e shpëlarjes së parave" si dhe "përshtatshmërinë me praktikën e mira". "Esenca ka qenë që të ecim me hapa të barabartë, që këto dy dokumente të ishin në harmoni", thotë Statovci për Radion Evropa e Lirë. Ajo shton se materiali do të përcillet në Qeverinë e Kosovës

për vlerësim, sapo të kthehet nga udhëtimi Kusari Lila, por nuk saktëson se kur mund të jetë kjo kohë.

Kryetari i Komisionit parlamentar për Industri, Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, i cili vjen nga Partia Demokratike e Kosovës në opozitë, thotë se arsyt e vonesave "mund t'i dijë vetëm partia në pushtet". "... por, nga ajo që dihet, është thjesht një neglizhencë dhe paaftësi organizative dhe menaxhuese e shumicës parlamentare për ta ndërtuar strukturën bazike të ligjit substancial", thotë Shala për Radion Evropa e Lirë.

Pasojat dhe përfitimet

REL-i iu drejtua edhe dy dikastereve qeveritare, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me pyetje për pasojat që i shkakton mungesa e një ligji që rregullon veprimtarinë e kriptovalutave, si dhe për përfitimet që do t'i sillte një masë e tillë. Por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje. Javën e kaluar, policia e Kosovës njoftoi se ka gjetur dhe konfiskuar 59 makina për mihjen e kriptovalutave në Mitrovicë të Veriut.

E kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, policia tha se në aksionet për konfiskimin e pajisjeve për kriptovaluta, ajo e asiston Doganën e Kosovës, e cila i trajton rastet e tilla.

Sipas të dhënave që siguroi REL-i nga Dogana, ky institucion gjatë vitit 2023 ka sekuestruar, mes tjerash, 383 pajisje për prodhim të kriptovalutave, 288 pajisje për konvertim të energjisë elektrike, 435 kartela grafike, 20 pllaka memorieje, 1 laptop dhe 72 pajisje të tjera për kriptovaluta - vlera e përgjithshme e të cilave ishte mbi 254 mijë euro.

Ndërsa, gjatë vitit 2022, vlera e pajisjeve për mihje kriptovalutash, të sekuestruara nga Dogana, ishte mbi 170 mijë euro.

REL-i kontaktoi edhe Administratën Tatimore të Kosovës, për të marrë informacion nëse ka persona që përfitojnë nga kriptovalutat dhe paguajnë tatim, por nuk mori përgjigje.

Ngjashëm nuk u përgjigj as Banka Qendrore e Kosovës, e cila ka për objektiv një sistem efikas të pagesave.

Situatë "kaotike"

Sipas deputetit Shala, dëmet nga mungesa e ligjit për kriptovaluta janë "të pallogaritshme". "Ne e

dimë që ekzistojnë, por nuk e dimë as kush sa paguan, sa prodhon, sa obligime i ka ndaj shtetit...", thotë ai.

Deputetja Statovci pajtohet se me ligj do të përfitonin edhe bizneset, edhe shteti.

Sipas saj, do të vihej rregull dhe do të eliminohehin pasiguritë që kanë shfrytëzuesit e kësaj industrie.

E gjithë kjo situatë për analistin e tregut dhe të investimeve në Kosovë, Arsim Ajeti, tash për tash është "kaotike".

Ai thotë se, në mungesë të ligjit, as shteti, as individët nuk janë në dijeni për përfitimet që sjellin kriptovalutat, por as për dëmet që shkakton mosrregullimi i fushës së tyre. "Po të ishte ligji i rregulluar, personat [që merren me to] do të paguanin tatim", thotë Ajeti dhe në këtë mënyrë, shton ai, ata mbahen nën kontroll dhe shteti përfiton.

Me ligj, sipas tij, do të parandaloheshin shumë rreziqe, si shpëlarja e parave, apo financimi i veprimtarive të tjera ilegale.

Veprimtaritë e tilla janë të mundshme sepse llogari për kriptovaluta mund të hapet çdokush dhe jo gjithmonë duhet t'u nënshtrohet kontrolleve që zakonisht bëjnë bankat.

Vëmendja e opinionit është kthyer te kjo çështje në fund të vitit të kaluar, kur Izraeli ka njoftuar se ka konfiskuar llogari të kriptovalutave që, sipas tij, kanë qenë të lidhura me Hamasin - grup i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera.

Vitin e kaluar, Bashkimi Evropian - ku Kosova synon të anëtarësohet - ka miratuar një rregullore për tregjet e kriptoseteve, e njohur si MiCa.

Ajo kërkon që firmat e kriptoseteve të autorizohen nga BE-ja për t'u shërbyer klientëve në bllok dhe t'i respektojnë masat mbrojtëse kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rregullorja, po ashtu, u kërkon ofruesve të shërbimeve të kriptoseteve që t'i ndajnë informacionet e detyrueshme me autoritetet tatimore.

Qeveria e Kosovës zgjeron skemën "Superpuna"

Prishtinë, 2 shkurt - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se do të vazhdojë platforma "Superpuna" e cila ka nisur një vit më parë. Përmes kësaj platforme ekzekutivi në Prishtinë subvencionon punëdhënësin duke paguar pagën e punëtorit për gjashtë muaj në vlerë prej 264 eurosh. Punëdhënësi, pastaj, ka të drejtë ta shtojë vlerën e pagës për punëtorin e angazhuar.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një ngjarje të organizuar për këtë çështje, tha se me vazhdimin e platformës do

të zgjerohet edhe grup-mosha e personave që do të kenë të drejtë të aplikojnë. "Nga 18 deri në 25 vjeç, tashmë do t'i zgjerojmë grup moshat e përfutuesve nga 18 deri në 29 vjeç", tha Kurti, duke shtuar se zgjerimi i skemës është bërë për shkak se platforma, sipas tij, ka pasur ndikim jashtëzakonisht të madh në punësimin e të rinjve.

Nga kjo platformë, sipas Kurtit, janë subvencionuar rreth 9 400 persona. Nga ky numër, 3 108 të rinj kanë vazhduar punën duke lidhur kontrata të rregullta me kompanitë private. "Kjo i bie që

67 për qind e punëtorëve të ndërmjetësuar përmes 'Superpuna' kanë vazhduar të qëndrojnë në tregun e punës", tha Kurti gjatë konferencës së bashku me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Sipas platformës "Superpuna", pas periudhës gjashtëmuajore, punëdhënësi mund ta mbajë në punë punëtorin duke nënshkruar kontratë të re, por edhe mund ta shkarkojë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, papunësia në Kosovë është 11.8 për qind.



Shqiptarët shtetin e shohin si forcë të huaj!

Nga: Ndrçim KULLA

Duke qenë se shqiptarët nuk kishin një mendësi të qartë shoqërore për shkak të rrethanave social-historike në zgjedhjen – si duhet – të vendimmarrësve të tyre, ata gjithmonë kanë qenë shumë të rrezikuar të binin në duart e ndonjë tirani dinak, i cili duke shfrytëzuar naivitetin e tyre do t'u bënte premtime të bukura duke iu thënë se nëse ia jepnin atij pushtetin, ai do ta përdorte "shkopin magjik" të shtetit për të plotësuar të gjitha kërkesat e tyre. Këtë rrezik kishte parasysh Noli kur thoshte në një fjalim të tij: "Liria mbrohet nga shkelësit e huaj me trimërinë e pushkës, nga shkelësit e brendshëm me trimërinë e shpirtit, me kurajën civile, e cila është më e lartë se e para".

1. Opozita e Nolit humbi në zgjedhjet e vitit 1923, sepse nuk iu premtoi shqiptarëve veçse punë të vështirë për të ndërtuar "shtëpinë e përbashkët", shtetin e prosperuar. Fituan ata që prematuan mrekullira me "shkopin magjik". Noli nuk blinte vota, kështu që nuk ishte fare tërheqës si politikan. Noli u ofronte shqiptarëve idealizmin e tij, u thoshte se donte të punonte për të ndërtuar një shtet ligjor sipas modelit perëndimor. Problemi i Nolit ishte se shqiptarët, të cilëve iu drejtohej, kishin një refuzim të lindur për ligjin dhe për shtetin, sipas modelit evropian, gjë që e kishte vënë re me shqetësim. Noli i njihje mirë shqiptarët. Fjalimi i tij i famshëm për pesë anarkitë e tregon qartë këtë. Ai e dinte se kujt ishte duke iu drejtuar, por si një idealist i pandreqshëm mendonte se mund t'i bindte shqiptarët me fjalët të cilat ata nuk i kuptonin.

Sot, kur citohet Noli për pesë anarkitë, nuk citohet për pjesën ku ai flet për rrugëdaljen prej tyre. Në fakt, Noli, pasi përshkroi me hollësi pesë anarkitë, përshkroi edhe sfidën me të cilën do të përballë ai që do të provonte të vinte rregull në vendin ku sundonin këto pesë anarki. Para se të dëbohej me armë nga pushteti, ai ishte ndëshkuar me votë nga elektorati refuzues ndaj ligjit dhe shtetit sipas modelit evropian. Shqiptarët e shikonin shtetin si një forcë të huaj, të cilin e shpërfillnin sa të mundnin, e refuzonin sa të mundnin dhe vetëm kur iu imponohej, i nënshtroheshin, pasi nuk kishin çfarë të bënin tjetër. Ideal për ta do të kishte qenë një shtet shqiptar që të ishte i pranishëm sa për dukje në fshatrat e qytetet e tyre, me ligjet e tij, policët, gjykatësit, nëpunësit, por që në thelb t'i lejonte të vazhdonin të jetonin siç kishin jetuar para tij, duke bërë me këtë shtet kompromisin që kishin bërë me shtetin turk. Zogu iu shkelte syrin bashkëkombësve dhe iu premtonte një shtet evropian me

fjalë, por një shtet të tillë, siç e donin ata me vepra.

Zogu nuk dinte të fliste kaq bukur sa Noli, por shqiptarët e kuptonin shumë më mirë Zogun se Nolin të cilin nuk e kuptonin fare. Shteti që premtonte se do të ndërtonte Noli i trembte ata. Nuk e gjenin veten në të, iu dukej i huaj. Në një fjalim të mbajtur në Parlament, më 1923, Noli, thoshte: "Cili është programi ynë? Duam një qeveri të popullit, prej popullit, për popullin, të përbërë prej njerëzve më të ditur, më patriotë, më të zotërit e më të ndershmit. Më të emëruar nëpunësit, duam të merret parasysh dituria, patriotizma, zotësia e nderi. Nuk duam të përjashtojmë asnjë qytetar i cili ka dituri, zotësi e vullnet të mirë, vetëm e vetëm se hyri pak a shumë vonë në sheshin e Shqipërisë së lirë. Duam ta lartësojmë racën tonë, jo ta skllavërojmë. Duam të respektohet nderi, liria dhe kryelartësia tradicionale e popullit shqiptar. Duam t'i japim popullit liri e jo tirani. Duam ta shtrojmë vendin tonë jo me dru, po me kanun e me drejtësi. Duam t'i rregullojmë financat e shtetit me kursim e jo ta shkatërrojmë shtetin me ryshfete e me taksa. Duam të ndërtojmë e jo të prishim. Organizatorët e huaj nuk i duam vetëm për bukuri e për të gënjyer popullin, por për të punuar e për të organizuar me të vërtetë. Duam t'u japim rëndësi kryesore degëve të bujqësisë, të shëndetësisë dhe të arsimit".

2. Gabimi i Nolit ishte se ai mendonte që bashkëkombësit e tij donin sundimin e ligjit, donin shtetin e fortë. Në fakt, ata donin vetëm aparencën e këtyre gjërave. Shteti që përshkruante Noli i trembte ata më shumë se kërbaci i Zogut. Prandaj, ata nuk entuziazmoheshin kur Noli thoshte se nuk do ta përdorte drurin. Ai mendonte se me këtë ua kishte fituar zemrën, por nuk e kuptonte se këta njerëz ishin mësuar me drurin dhe dinin si të merreshin veç me atë që kishte kërbacin e shtetit në dorë. Kjo ishte gjuha që ata e kuptonin mirë brez pas brezi. Ai që kishte kërbacin në dorë iu thoshte se unë e di që ju tregoni mospërfillje sa të mundni për ligjin dhe shtetin e unë ua njoh këtë të drejtë. Por, unë kërkoj nga ju që t'i nënshtrohëni sa për dukje ligjit dhe autoritetit të shtetit, që Evropa të shohë se ne kemi një shtet modern. Nëse ju nuk cenoni pushtetin tim, unë nuk do t'u cenoj juve më tepër se kaq dhe do t'u lejoj të jetoni siç keni jetuar brez pas brezi. Nëse disa nga ju dëshirojnë ta ndryshojnë mënyrën e jetesës aq më mirë.

Dhe, kështu u arrit kompromisi i heshtur mes Zogut dhe shqiptarëve, që i mundësoi Zogut të bëhej mbret dhe ta mbante pushtetin deri kur u largua nga Shqipëria. Një njohëse e mirë e Shqipërisë, baronesha gjermane



Marie Amelie Frein von Godin, në librin e saj "Nga Shqipëria e re", të botuar më 1914, shihet si një problem të madh për shqiptarët në shtetin e tyre të ri, atë që ata nuk ishin mësuar të kishin interesa publikë: Për vështirësitë që kryesisht i kundërvihen një aksioni mbarëkombëtar në Shqipëri, mund të krijojë një ide vetëm ai që njeh vendin dhe karakterin popullor. Për shkak të shtypjes shekullore, gjatë së cilës shqiptarëve u ishte mohuar, madje me kërcënimin e dënimeve të rënda, çdo pjesëmarrje në jetën politike, pjesa më e madhe e popullatës ishte çmësuar të interesohet për çështjet publike dhe kjo, siç ishte e natyreshme, nga shpërfillja e plotë e ngjarjeve politike, çoi në humbjen e krejt shpresave për të ardhmen, që tek çdo popull tjetër, jo kaq të shkathët dhe energjik, do ta kishte degjeneruar në një letargji të thellë dhe pa shpëtim.

3. Pikërisht mungesa e interesimit të shqiptarëve për çështjet publike mund të shihet si arsyeja që në vend mbisundonin pesë anarkitë për të cilat fliste Noli. Një konstatim të ngjashëm me atë të Baroneshës von Godin, por të shprehur me më shumë hollësi, ka bërë 25 vjet më vonë një gazetar i shquar italian, Indro Montanelli, në librin e tij "Shqipëria një dhe një mijë", i cili gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri vuri re se përveç një elite intelektuale, te shqiptarët e thjeshtë mungonte interesimi për çështjet publike dhe se ata ishin të shqetësuar vetëm për gjëra që kishin lidhje drejtpërdrejt me interesat e tyre private. Montanelli shkruan: "Pyeta fshatarë, blegtorë dhe njerëz të thjeshtë: 'Çfarë do të dëshironit?', m'u gjegjën, çdonjëri

me fjalë të tija, por të gjithë në të njëjtën mënyrë: 'Dëshirojmë që të mos vidheshin paratë që Italia jep për përmirësimin tonë, që kjo tokë të kthehet nga moçal në bashtinë, që një rrugë të vinte deri këtu, që të kishte një shkollë ku të shpiem fëmijët, që ta kishim bukën të siguruar dhe jo të varur nga trilli i shirave dhe i diellit, që malaria të zhdukej, që qetë t'i kishim më të shëndoshë, që shtëpinë ta kishim shtëpi dhe jo kasolle të ndyrë'. Këtë më thoshin fshatarët. Askush nuk më tha ndonjëherë se lypsej organizuar një parti apo lypseshin kufizuar fuqitë e shtetit. Askush nuk kërkonte liri. Bukë kërkonin, edhe rrugë, edhe tokë për të lëvruar, edhe shtëpi, edhe qe. Ndërsa, mua më shkante mendja, si për sa e sa kryevepra të humorizmit, te librat që kisha lexuar mbi Shqipërinë, libra gazetarësh francezë, anglezë, amerikanë, në të cilët dëftohej se problemi shqiptar qenkësh një problem organizimi i lirive demokratike".

4. Askush nuk ishte interesuar për çështje publike jashtë sferës së tij të interesave private! A mund të thuhet se e kishte tepruar ky gazetar italian dhe se e vërteta nuk ishte pikërisht kështu si thoshte ai? Në fakt, edhe sot ne kemi dëshmi të panumërta, në të gjithë televizionet shqiptare, që kur gazetarët u drejtojnë mikrofonin njerëzve të thjeshtë në të gjitha anët e vendit, askush nuk flet për çështje publike, përveçse kur e pyesin drejtpërdrejt për diçka të tillë. Përndryshe, të gjithë flasin vetëm për çështje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me interesat e tyre private.

Shqiptarët e sotëm, jo më pak se

ata me të cilët bisedoi Durhami më shumë se një shekull më parë, e shpërfillin dhe e refuzojnë ligjin dhe shtetin me sa të mundin, gjë që e demonstrojnë me ndërtimet e shumta pa leje, me kultivimin masiv të bimëve narkotike, me mospagimin e energjisë elektrike dhe të ujit etj. Shqiptarët i binden pa dëshirë ligjit dhe shtetit, vetëm kur detyrohen ta bëjnë këtë gjë me mjete shtërnguese. Dhe, shqiptarët ndoshta janë unikë për indiferentizmin e tyre shoqëror në mospërfilljen e tyre dhe refuzimin e tyre për ligjin dhe për shtetin. Mospërfillja dhe refuzimi i shqiptarëve për ligjin dhe shtetin nuk është një dukuri që shfaqet vetëm te njerëzit e thjeshtë, por edhe tek elitat politike, të cilat e shfaqin në mënyrën e tyre mospërfilljen për ligjet dhe shtetin. Thjesht duke mos i zbatuar ligjet që kanë bërë vetë, kur nuk iu intereson atyre. Shqiptari edhe sot për fat të keq është e vështirë të shikojë përtej pragut të shtëpisë, ndryshe nga bashkëkohësit e tyre evropianë, që sillen si genie shoqërore. Kjo është edhe sot një nga plagët e vjetra historike, që stigmatizonte dikur Lumo Skëndo alias Mitad Frashëri te libri i tij "Plagët tona", por që e kanë vënë në dukje edhe rilindës të tjerë.

Referencat

- (Fan S. Noli, Vepra, Akademia e Shkencave, vol. VI., Tiranë 1996, f. 140)
- (Fan S. Noli, Vepra, Akademia e Shkencave, vol. VI., Tiranë 1996, f. 143)
- Marie Amelie Frein von Godin: "Nga Shqipëria e re", Shtëpia botuese "Koçi", Tiranë 2007, f. 21)
- (Indro Montanelli: "Shqipëria një dhe një mijë", Shtëpia botuese "55", Tiranë 2005, f. 109-110)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Zyba: Kalimi te Legia është përmbushje e ëndrrës sime

VARSHAVA, 2 SHKURT - Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës, Qëndrim Zyba, është shprehur i lumtur pas transferimit te gjiganti polak Legia Varshava. Zyba iu ka bashkuar kësaj skuadre në formë huazimi për gjashtë muaj dhe me të drejtën e

blerjes. Mesfushori i talentuar është shprehur i lumtur me transferimin dhe i gatshëm të "luftojë" për fanellën e Legias. "Jam shumë i lumtur dhe krenar sepse jam në një vend të veçantë. Unë iu bashkova Legia Varshavës, klubit më të

madh në Poloni, me tifozët më të mirë dhe ambiciet e kampionatit. Kjo ditë është përmbushja e ëndrrës sime që kam kohë që punoj", ka thënë Zyba. "Do të doja t'i jepja Legias gjithë të mirat dhe t'i fitoja zemrat e tifozëve me paraqitjet e mia të mira. E

di që mund të zhvillohem në një klub të tillë. Unë jam një lojtar që jap gjithçka në fushë, luftoj nga fillimi deri në fund. Kam vënë gjithë zemrën time në çdo ndeshje dhe stërvitje", ka shtuar Zyba, i cili te Legia ka zgjedhur fanellën me numër 11.



Në kryeqytet ndajnë mejdantin rivalët e vjetër

Dy skuadrat që njihen për rivalitetin e madh në basketbollin e Kosovës, Sigal Prishtina dhe Peja, sot (e shtunë) nga ora 17:00 përballen në kryeqytet. Në këtë edicion nga dy përballjet e zhvilluara këto klube kanë regjistruar nga një fitore dhe tash janë në kërkim të fitores së dytë në përballje të drejtpërdrejtë. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Bashkimit dhe Trepçës, ndërsa të dielën në program janë dy ndeshje të tjera

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 SHKURT - Vëmendja e të gjithë dashamirëve të futbollit do të jetë në kryeqytet të shtunën, pasi Sigal Prishtina dhe Peja përballen në kuadër të javës 20 në Prince Caffè Superligë. Përballja mes dy rivalëve të vjetër pritet të sjellë një superndeshje dhe një atmosferë në kryeqytetin e Kosovës. Prishtinasit janë në vendin e tretë me 13 fitore e gjashtë humbje, ndërsa pejanët kanë 14 fitore e pesë humbje, duke ndarë vetëm një pikë mes tyre, prandaj kjo do ta bëjë edhe më

interesante këtë përballje. Në dy përballjet e këtij edicioni, të dyja skuadrat kanë regjistruar nga një fitore. Pejanët triumfuan në Prishtinë 80:95, ndërsa kryeqytetasit në Pejë, 78:81. Kjo

SUPERLIGA - Java 20

Të shtunën takohen:

17:00 Sigal Prishtina - Peja
19:00 Bashkimi - Trepça

Të dielën takohen:

17:00 Istogu - Vëllaznimi
19:00 Golden Eagle Ylli - Proton Cable Prizreni



ndeshje zhvillohet nga ora 17:00, ndërsa dy orë më vonë zhvillohet përballja tjetër shumë interesante në mes të Bashkimit dhe Trepçës, ku të dy skuadrat hyjnë vetëm për fitore. Prizrenasit janë në vendin e gjashtë me shtatë fitore dhe 12 humbje, kurse mitrovicasit në vendin e parë me 17 fitore e dy

humbje. Këtë edicion 'Xehetarët' kanë dy fitore ndaj portokallezëve, 77:99 dhe 84:67. Nesër (e diel) në Gjakovë do të zhvillohet ndeshja mes dy skuadrave nga Rrafshi i Dukagjinit, Istogut dhe Vëllaznimit. Kuqezinjtë janë favoritë, pasi numërojnë tetë fitore dhe 11 humbje, ndërsa

istogasit vetëm një fitore e 18 humbje. Takimi i fundit i kësaj xhiroje, por mjaft i rëndësishëm, është në mes të Golden Eagle Yllit dhe Proton Cable Prizrenit. Therandasit janë në vendin e katërt me 11 fitore dhe tetë humbje, kurse prizrenasit në vendin e shtatë me pesë fitore e 14 humbje.

Futbolli rikthehet me ndeshjet e Kupës



PRISHTINË, 2 SHKURT - Pas periudhës së pushimit dimëror, klubet e futbollit në Kosovë u rikthehen garave këtë fundjavë, me ndeshjet e fazës së 1/8 së finales së Kupës së Kosovës. Katër ndeshje do të zhvillohen sot (e

shtunë), katër të tjera do të zhvillohen nesër (e diel), e të cilat pritet të sjellin emocione dhe rivalitet. Ndeshja kryesore pritet të jetë ajo në mes të Gjilanit dhe Prishtinës. Këto dy skuadra kanë synime të mëdha në garën e

Kupës dhe në këtë ndeshje luajnë për fitore. Përballje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Feronikelit dhe Malishevës. Në dy ndeshjet e tjera do të përballen Suhareka - Prishtina e Re dhe Vjosa - 2 Korriku. Të dielën

përballje interesante do të zhvillohet në Mitrovicë në mes të Trepçës '89 dhe Llapit, kurse Ballkani e pret Vëllaznimin e Gjakovës. Drita ka punë me Rilindjen 1974, kurse Dukagjini është nikoqir i Dinamos.

Broja pas kalimit në Fulham: Mezi pres të luaj në 'Craven Cottage'

Londër, 2 shkurt - Sulmuesi shqiptar Armando Broja ka thënë se ndihet shumë i lumtur që ka kompletuar kalimin te Fulhami nga Chelsea në afatin kalimtar të janarit. Fulhami arriti ta fitojë garën me klubet e tjera të interesuara angleze për shërbimet e 22-vjeçarit shqiptar pas bisedimeve të stërzgjatura me "Blutë". Zyrtarizimi i Brojës

erdhi vetëm pas mesnatës, si një huazim deri në fund të sezonit 2023/24. Pas zyrtarizimit, 22-vjeçari do të kërkojë të ndikojë këtu, ngjashëm si më parë në skuadrën holandeze Vitesse dhe te Southamptonin në Ligën Premierë. "Ndihehem mrekullueshëm. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe mezi

pres të filloj, t'i takoj lojtarët dhe menaxherin dhe të luaj për tifozët. Tifozët luajnë gjithmonë një rol të madh dhe mezi pres të shkoj në 'Craven Cottage' dhe t'i takoj të gjithë. Do të punoj shumë për ekipin dhe do të krijoj një lidhje të vërtetë. Jam vërtet i nderuar dhe i emocionuar që jam këtu", ka thënë Broja.



Hamiltoni edhe zyrtarisht kalon te Ferrari

MARANELLO, 2 SHKURT - Lewis Hamiltoni do ta veshë fanellën e kuqe të Ferrarit duke filluar nga viti 2025. Ekipi nga Maranellos e bëri të ditur këtë menjëherë pas njoftimit për shtyp të Mercedesit, në të cilin u njoftua se shtatë herë

kampioni i botës do të largohet nga ekipi britanik në fund të vitit 2024, pas 12 sezonesh. "Skudra Ferrari ka kënaqësinë të njoftojë se Lewis Hamiltoni do t'i bashkohet ekipit më 2025, me kontratë shumëvjeçare", thuhej në

njoftim. Hamiltoni do ta zëvendësojë Carlos Sainzin, i cili tashmë ka bërë me dije se do të japë gjithçka në këtë sezon të tij të fundit me Ferrarin. Pas zyrtarizimit të Hamiltonit, erdhën fjalët e Carlos

Sainzit: "Pas lajmeve të sotme, unë dhe skuadra Ferrari nuk do të vazhdojmë bashkë pas vitit 2024. Kemi ende një sezon të gjatë përpara dhe si gjithmonë do të jap gjithçka për ekipin dhe për tifozët në mbarë botën".



Gravina: Shqipëria është rritur shumë, Italinë e pret një përballje e fortë

Romë, 2 shkurt - Presidenti i Federatës Italiane të Futbollit, Gabriele Gravina, ishte i pranishëm në ekspozitën e famshme mbi jetën dhe karrierën e ish-sulmuesit të madh italian Paolo Rossi. Në një deklaratë për mediet ai u shpreh se Shqipëria e ka rritur shumë nivelin dhe se Italia e tij nuk do ta ketë të lehtë në Evropian. "Jemi dy vende të ngjashme, Italia dhe Shqipëria, ndajmë shumë aspekte kulturore. Shumë shqiptarë jetojnë te ne, jo vetëm në botën e punës, por edhe në botën e sportit kemi shumë ngjashmëri. Jemi dy popuj që respektohen dhe që duhen, dhe që gjithsesi gjithmonë kanë gjetur mënyrën si të rrinë bashkë dhe kjo është shumë pozitive", ka thënë Gravina. I pyetur se Paolo Rossi në historinë e tij ishte dhe shembulli që edhe përrallat mund të bëhen



realitet, si do ta konsideronit nëse do të bëhej realitet përralla e Shqipërisë që mund Italinë në evropian, Gravina është përgjigjur: "Jo, jo, kjo është një përrallë që nuk na pëlqen ne italianëve, përralla e Paolo Rosit ishte për ne një hero, pa kohë i

jashtëzakonshëm. Duhet të them futbollistikisht e kam parë Shqipërinë disa herë. Siç e dini, jemi përballur disa herë. Në vitet e fundit është rritur shumë, por është rritur shumë niveli i futbollit botëror, do të thotë që nuk ka më 'hirushe' në botën e futbollit".

Lakersat shkëlqejnë edhe pa yjet në fushën e Bostonit



BOSTON, 2 SHKURT - Ekipi LA Lakers ka fituar me rezultat 114-105 në fushën e Bostonit, duke befasuar me paraqitjen e tij edhe pse në fushë mungonin LeBron Jamesi dhe Anthony Davis. Të

rinjtë shkëlqyen. U dallua Reaves me 32 pikë. Për Bostonin, që pavarësisht humbjes ruan kreun e renditjes në Lindje, u dallua Tatum me 23 pikë. Fitoi edhe ekipi i New Yorkut, që mundi

Indianan (109-105), në një ndeshje me rivalitet deri në fund. Brunsoni me 40 pikë ishte lojtari më i mirë në fushë për nju-jorkezët. Fitoren e 30-të sezonale korri skuadra e Philadelphia, që mposhti me rezultat 127-124 Utah Jazzin jashtë fushës. Ndeshje magjike për Tyrese Maxey, që realizoi 51 pikë për Philadelphia. Befaso i ekipi i Clevelandit, që mundi me rezultat 108-101 Memphisin. Mitchell realizoi 25 pikë për miqtë, lider në fushë, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Jacksonit për Memphisin.

REZULTATET

Boston - Lakers	105-114
New York - Indiana	109-105
Memphis - Cleveland	101-108
Utah Jazz - Philadelphia	124-127

SHKURT

KB Ylli arrin marrëveshje me trajnerin Petar Mijoviq

Klubi i basketbollit Golden Eagle Ylli ka bërë me dije se ka arritur marrëveshje me trajnerin e njohur Petar Mijoviq. Kështu ka njoftuar ky klub përmes një shkrimi në "Facebook". Trajneri Mijoviq me shtetësi malazeze edhe më parë ka punuar në Kosovë dhe ka vazhduar më pas në skuadrën nga Superliga e Polonisë, Slask Wroclaw, në Superligën e Hungarisë Atomeromu SE si dhe në Mal të Zi te skuadra e Budućnost me të cilën edhe ka marrë pjesë në EuroCup si dhe ka fituar titullin e kampionit në Mal të Zi. "Tani objektivat janë të qarta që me trajnerin kampion të rikthehemi te titulli kampion", ka njoftuar skuadra suharekase.

Lara Colturi, e bronzë në Francë

Lara Colturi shënon një tjetër arritje për sportin shqiptar. Ajo ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Botëror të të rinjve. Gjithçka ka ndodhur në Francë, ndërsa është renditur e treta në Sllallomin Gjigant. Colturi do të konkurrojë edhe të shtunën në Sllallomin Special, teksa synohet një tjetër medalje. Madje, sipas informacionit që vjen nga Federata Shqiptare e Skive, për më tepër nga presidenti Elvis Toçi, synohet e arta, ashtu sikurse ka ndodhur dhe vitin e kaluar në të njëjtin aktivitet. Lara Colturi ka shkëlqyer në Kupën e Botës duke qenë brenda dhjetëshes së parë. Ndaj dhe pritet medalje nga Colturi, ashtu sikurse ka bërë edhe në garat e tjera duke mbetur mbretëresha e sporteve dimërore.

Superliga Evropiane fillon në vitin 2025, Laporta zbulon klubet pjesëmarrëse

Superliga Evropiane pritët të marrë udhë në vitin 2025. Për këtë gjë është i bindur presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, i cili deklaroi se, pavarësisht prej sfidave të shumta, vendimi i Gjykatës Evropiane për Drejtësi ka hapur rrugën për kompeticionin më të ri për klube. Laporta deklaroi se në fillim të rrugëtimit në Superligën Evropiane nuk do të jenë klubet angleze, teksa nuk ngurroi t'i zbulojë edhe emrat e disa skuadrave që do t'i bashkohen rrugëtimit. "Superliga Evropiane do të nisë brenda 2025-s dhe në fillim të rrugëtimit nuk do të jenë klubet angleze. Ato e kanë tashmë një Superligë, që është kampionati anglez. Do të jenë Reali e Barcelona, 4 klubet italiane si Interi, Milani, Roma e Napoli, francezët e Marseilles, portugezët Porto, Benfica e Sporting Lisbona, holandezët Ajax e PSV dhe belget e Brugge dhe Anderlecht", u shpreh presidenti i Barcelonës.

Laporta solli në vëmendje faktin se ai që sot është kompeticioni më i rëndësishëm në Evropë, Ligën e Kampionëve, nisi me më pak skuadra në 1955-n dhe me shumë skepticizëm, për të arritur në nivele të jashtëzakonshme.

Kloppi: Për titull duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet

Liverpooli kryeson Premierë Ligën dhe këtë fundjavë ka një përballje të vështirë ndaj Arsenalit në Londër. Një sfidë delikate për "Reds", por kjo nuk tremb trajnerin Jurgen Klopp, që i ka idetë e qarta në lidhje me titullin. "Nëse duam

të mposhtim Manchester Cityn dhe ta fitojmë kampionatin duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet deri në fund të sezonit, sepse kjo është ajo që bëjnë rivalët tanë. Ata i fitojnë të gjitha", ka thënë Klopp. "Kjo është Premierë Liga, kjo është koha e

Manchester Cityt, që po dominon prej disa sezonesh. Ata mund të thonë se nuk janë duke bërë sezonin e tyre më të mirë, por janë aty ku janë. Ata janë dy pikë prapa nesh", u shpreh më tej trajneri gjerman. "Ne thjesht duhet të

përpiqemi të luajmë sezonin më të mirë. Kur përballemi me ta, duhet t'i mposhtim ata. Kjo vlen edhe për Arsenalin, pasi është shumë pranë nesh në renditje. Ne do të përpiqemi ta bëjmë sa më të vështirë që të jetë e mundur

sezonin për rivalët tanë dhe të fitojmë. Golat e minutave të fundit? Pesë zëvendësimet të ndihmojnë të hedhësh forca të freskëta në fushë dhe ne përfitojmë nga ky fakt", ka deklaruar Klopp.

Në bazë të dispozitave të nenit 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht neni 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), Komisioni i Auditimit i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A, në Pejë, në mbledhjen e mbajtur më datë: 20.12.2023, nxjerr vendim që të shpall:

KONKURS

Konkurs për Auditor të brendshëm

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A. PEJË
Nr. 141
Date: 02.02.24

Pozita: Auditor i Brendshëm.

I përgjigjet: Komisionit të Auditimit.

Vendi: Pejë

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të Komisionit të Auditimit dhe aprovar nga Bordi i Drejtorëve.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, komfor objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuata për Komisionin e Auditimit;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontroleve të ndërlydhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit;

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përbushë të gjitha kushtet e parafshirë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëmitë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/apo Financave dhe Kontabilitetit;
- Çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.

Njohurit dhe shkathtësitë profesionale

- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Njohuri e Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;
- Shkathtësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;
- Shkathtësi kompjuterikë në programet kompjuterike, Micr. Word, Excel dhe Acces;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- Deklarata nën betim për auditor të brendshëm
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
- Letër Motivimin,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Kompanin KRM Ambienti në zarf të mbyllur me shënim:

Për pozitën: Auditor i Brendshëm i KRM "Ambienti" Sh.A.

Aplikacioni dhe deklarata në betim tërhiqen në ndërmarrje me kërkesë të kandidatit

Vlerësimi, intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Komisioni i Auditimit e mban të drejtën e formimit të listës së ngushtë me aplikantët.

Konkursi është i hapur nga data 03.02.2024 deri me 04.03.2024, e-mail krm.ambienti@yahoo.com



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 02.02.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës:

KONKURS

Pozita : Punëtor Fizik 7 pozita vendi i punës Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Punëtori Fizi ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
2. Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e kontenjerëve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së Kontenjerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres Shoferit, Kryepunëtorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Shoferit, Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshetit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkollimi fillorë
- Afësi fizike dhe psikike të deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen. Konkursi është i hapur nga data : 03.02.2024 deri me 19.02.2024. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letër Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "LURN" Sh.p.k, Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaik 3.5 MWp, Z.K. Bellopojë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.03.2024 në ora 10:00 në hapësirat e Komunës së Istogut, Shtëpia e Kultures në Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania "LURN" Sh.p.k, Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "LURN" Sh.p.k, Prishtinë për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaik 3.5 MWp, Z.K. Bellopojë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Solar Tec 2" Sh.p.k. - Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parku Solar Impiamnti Fotovoltaik 70.4 MWp në Gllanasellë, Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.03.2024 në ora 11:00 në ambientin e gjimnazit "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" në hapësirat e bibliotekës së saj, do të organizohet debat publik nga Kompania "Solar Tec 2" Sh.p.k. - Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us04web.zoom.us/j/71109467727?pwd=zFy999ZII1YTwvsNeclwjg7JYctGfP.1>

Meeting ID: 711 0946 7727
Passcode: 5HhJPJ

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Solar Tec 2" Sh.p.k. - Prishtinë, për Parku Solar Impiamnti Fotovoltaik 70.4 MWp në Gllanasellë, Drenas.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ZIA" SH.P.K. me seli në Vushtrri me pronar Agron Rashica, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812041200 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ZIA" D.O.O. od Vuqiterna, sa vlasnikom Agron Rashica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812041200 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "ZIA" L.L.C. with headquarters Vushtrria, with owner Agron Rashica, has come to the decision to quit its business: 812041200 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valon Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Fiona Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës fillore "7 Shtatori" Greqinë.

- Ardian Imeri nga Nivokazi, K.K Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e së mesme "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakova.

- Halil Mala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Artan Ademaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari".

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Luigj Gurakuqi", Korenicë.

- Ylfete Spasi (Vehapi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Mefide Qarhaxhije (Zajmi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

